

A B C D E F G H I J K L M N O P Q R R R R S S S H T T T U V X X H Y Z Z H -

○ ○  
Për nivelin  
e dytë

**Hazir Mehmeti**  
**Nexhmije Mehmetaj**  
**Rifat Hamiti**

# NJË BOTË PËR TË GJITHË



**EMRI DHE MARRËSI** \_\_\_\_\_

**KLASA** \_\_\_\_\_

**SHKOLLA** \_\_\_\_\_

**VENDI** \_\_\_\_\_

**SHTETI** \_\_\_\_\_



Këtë libër e gjeni edhe në versionin elektronik dhe mund ta shkarkoni nga uebfaqja e MASHIT të Kosovës <https://www.mashit-gov.net>



**duk gjini**



Hazir Mehmeti, Nexhmije Mehmetaj, Rifat Hamiti

# NJË BOTË PËR TË GJITHË

Fletore tematike  
për nivelin e dytë

**duk<sup>a</sup>gjini**

**MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS  
DHE E TEKNOLOGJISË E KOSOVËS**

**TEKSTE MËSIMORE PËR SHKOLLËN SHQIPE  
TË MËSIMIT PLOTËSUES NË DIASPORË**

Autorë/e:

Besa Luzha, Hazir Mehmeti, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti, Nexhat Maloku,  
Nexhmije Mehmetaj, Rifat Hamiti, Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj, Xhevat Syla.

Hartues/e të këtij teksti: Hazir Mehmeti, Nexhmije Mehmetaj, Rifat Hamiti

Koordinatorë: Arif Demolli, Basil Schader, Nuhi Gashi

Projekti është mbështetur nga Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut  
(Instituti IPE – International Projects in Education) dhe  
Fondi i Llotarisë i Cyrihut (Lotteriefonds des Kantons Zürich) në Zvicër.



**LOTTERIEFONDS  
KANTON ZÜRICH**

## PËRMBAJTJA

1. Atdheu im.....	4
2. Në bregdetin tonë.....	6
3. Mua më pëlqen vendi ku jetoj.....	8
4. Shtëpia ime.....	10
5. Në lagjen time.....	12
6. Festë në qytet.....	14
7. Në bibliotekë.....	16
8. Një botë për të gjithë.....	18
9. Të drejtat dhe përgjegjësitë në shkollë / në klasë.....	20
10. Shëndeti ynë.....	22
11. Teuta dhe Iliri.....	24
12. Dhurata e ditëlindjes.....	27
13. Të kujt janë këto rroba?.....	29
14. Mjedisi jetësor.....	31
15. Pemët dhe perimet.....	33
16. Kafshët në natyrë.....	35
17. Stinët e vitit.....	37
18. Jeta e përbashkët.....	40
19. Jeta dikur dhe sot.....	42
20. Pse jemi të ndarë?.....	44





## 1. Atdheu im

Mësimi i gjuhës shqipe filloi. Mësuesja i pyeti disa nxënës për vendlindjet e tyre.

- Arta, na thuaj si quhet vendi ku ke lindur? - pyeti mësuesja.
  - Vendi ku kam lindur quhet vendlindje, – u përgjigj Arta.
  - Bukur, Arta. Pra cila qenka vendlindja jote? - pyeti përsëri mësuesja.
  - Vendlindja ime është vendi ku jetoj dhe shkollohem, - u përgjigj Arta.
  - Mirë, Arta. Po prindërit e tu nga janë? - vazhdoi mësuesja.
  - Prindërit e mi janë nga Prishtina, mësues, - tha Arta.
  - Po prindërit e tu, Vlora, nga janë? - pyeti mësuesja.
  - Nga Tirana, - u përgjigj shkurt Vlora.
  - Alban, na trego edhe ti nga janë prindërit e tu? - vazhdoi mësuesja.
  - Prindërit e mi janë nga Shkupi, - u përgjigj Albani.
  - Pra prindërit e Artës janë nga Kosova, të Vlorës nga Shqipëria, kurse ata të Albanit nga Maqedonia, - tha mësuesja. - Në klasën tonë kemi nxënës që janë edhe nga Ulqini e Presheva, - shtoi ajo.
  - Atëherë kush do të më thotë çka janë këto shtete e vende për ju? - pyeti mësuesja.
  - Këto shtete, prej nga janë prindërit tanë, për ne janë Atdheu ynë, - u përgjigj bindshëm Drini.
  - Të lumtë, Drin! Ashtu është. Tash më thuaj nga vjen fjala Atdhe? - vazhdoi mësuesja.
- Të gjithë nxënësit shikuan njëri-tjetrin, duke ngritur supet në shenjë se nuk e dinin prejardhjen e fjalës më të dashur për të gjithë ne, Atdhe.
- Para se ta sqaronte fjalën Atdhe, mësuesja mori të lexonte vjershën me të njëjtin titull, të shkrimtarit tonë shumë të njohur, të quajtur “bilbili i letërsisë shqipe”, NAIM FRASHËRIT (1846 – 1900). Me këtë dëshirë edhe më shumë t’i zgjojë emocionet e nxënësve.

## Atdheu

O Atdhe, më je i dashur sa më s'ka,  
Më je nënë, më je motër, më je vëlla.  
Nga ç'ka rrotull më i shtrenjti ti më je,  
Je më i miri nga çdo gjë që ka ky dhe.

### Të sqarojmë nga vjen fjala Atdhe.

*Kjo fjalë përbëhet nga dy fjalë.*

*Fjala **atë**, që do të thotë baba, kurse fjala **dhe** do të thotë tokë. Pra me fjalë të tjera ndryshe dheu, toka e babait.*

*Por, pasi nga kjo tokë vjen edhe nëna, e që ndryshe quhet **mëmë**, atëherë **atdheu** quhet edhe **mëmëdhe**.*

### Aktivitete

**1) Lexojeni tekstin sipas roleve. Kujdes shenjat e pikësimit!**

**2) Lexojeni dhe mësoni përmendsh vargjet e vjershës “Atdheu”!**

**3) Përgjiguni pyetjeve vijuese!**

Cilat janë personazhet e tregimit? 1. \_\_\_\_\_ 2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_ 4. \_\_\_\_\_ 5. \_\_\_\_\_

Cilat qytete përmenden në këtë tregim? 1. \_\_\_\_\_ 2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_ 4. \_\_\_\_\_ 5. \_\_\_\_\_

Kush e shkroi vjershën “Atdheu”? \_\_\_\_\_

Si quhet ndryshe ky poet? \_\_\_\_\_

Çka janë për ju Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Presheva e Ulqini? \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Cili është kryeqyteti i Shqipërisë? \_\_\_\_\_

Cili i Kosovës? \_\_\_\_\_ Cili i Maqedonisë? \_\_\_\_\_

Ku ke lindur ti? \_\_\_\_\_

Ku kanë lindur prindërit e tu? \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**4) Çka është Atdheu për ty? Shkruaj mendimet e tua në një fletë të veçantë dhe diskutoji me shokët/shoqet e klasës dhe me mësuesin/en!**

**5) T’i shtojmë njohuritë:** Pos Naimit, për Atdheun kanë shkruar vjersha edhe shumë shkrimtarë të tjerë. Në mes tyre edhe poeti tjetër ynë i madh Andon Zako Çajupi. Poezia e tij quhet “Mëmëdhe”. **Gjejini këtë poezi në libra ose në internet dhe lexojeni atë në shtëpi apo klasë!**





## 2. Në bregdetin tonë

Një ditë, pasi mbaroi mësimi, u nisëm me makinë për në pushime verore. Po shkonim në bregdetin tonë babai, nëna unë dhe vëllai. Kaluam Gjermaninë, Austrinë, Slloveninë, Kroacinë.

Në mbrëmje arritëm në qytetin Ulqinin, në Mal të Zi, ku pjesa dërmuese e banorëve janë shqiptarë. U vendosëm në një banesë afër Plazhit të Madh. Ditën laheshim e rrezitëshim në rërën e nxehtë të plazhit, kurse në mbrëmje dilnim për të shëtitur buzë Plazhit të Vogël të Ulqinit. Një natë u ngjitëm për të ngrënë darkë edhe në Kalanë e vjetër të Ulqinit. Çfarë pamjeje të bukur kishte deti nga aty! Na bëri përshtypje jehona e këngës shqipe që dëgjohej kudo.

Me mbresa të mira nga Ulqini, pas tri ditësh u nisëm në drejtim të Shqipërisë. Duke kaluar kufirin, kalum nëpër **Shkodër**, ku vizituam kështjellën e Rozafatit. Pastaj **Velipojën** dhe arritëm në **Shëngjin**. Aty qëndruam tri ditë të tjera dhe u kënaqëm. M'u bë se rëra e Ulqinit kishte ardhur e tëra në këtë plazh.

Tri ditë kaluam edhe në plazhin e **Durrësit**, kurse pastaj tri ditë edhe në **Radhimë**, afër **Vlorës** së pavarësisë.

Vazhduam udhëtimin tonë në jug të Shqipërisë. Në plazhin e **Himarës** qëndruam dy ditë e pastaj shkuam në **Sarandë**.

Tash u binda çfarë bukurish bregdetare ka Atdheu ynë dhe çfarë uji të pastër e të ngrohtë kanë **deti Adriatik** dhe **deti Jon**.

Pas dy javë e gjysmë pushim në bregdet u kthyem në Kosovën tonë për t'i kaluar edhe dhjetë ditë të tjera të pushimit. Kurrë nuk do ta harrojmë këtë pushim të bukur në bregdetin tonë.

## Aktivite

### 1) Përgjigjuni me gojë ose me shkrim këtyre pyetjeve:

Ku i kaloi pushimet verore kjo familje? \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Cilat shtete kaloi ajo? \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Sa plazha ka Ulqini dhe cilat janë ato? \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Ku hëngri darkë familja? \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Çka u bëri përshtypje atyre? \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Në cilat plazha shkuan pastaj anëtarët e kësaj familjeje? \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Pasi kaluan gjitha plazhet për çka u bindën ata? \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Cilat dete ka Shqipëria? \_\_\_\_\_

### 2) Shkruaj sipas radhës këta emra të qyteteve bregdetare shqiptare nga jugu në veri! Vlora, Ulqini, Saranda, Velipoja, Radhima, Shkodra, Himara, Shëngjini! (Shih edhe në një atlas ose hartë).

1. \_\_\_\_\_ 2. \_\_\_\_\_ 3. \_\_\_\_\_ 4. \_\_\_\_\_

5. \_\_\_\_\_ 6. \_\_\_\_\_ 7. \_\_\_\_\_

### 3) Shkruaj në një fletë të veçantë ku, si dhe me kë i kalove pushimet verore!



### 3. Mua më pëlqen vendi ku jetoj

Unë quhem Gentiana. Jam 12 - vjeçare dhe jetoj në Zvicër.

Kam një familje të madhe. Babai im është 40 vjeç. Ai quhet Agron.

Kurse nëna ime është dy vjet më e re se babai dhe quhet Teuta.

Besniku është vëllai im. Ai nuk Punon, por mëson. Besa është motra ime. Ajo ka lindur 3 vjet para meje. Babai im ka një motër. Ajo quhet Bute dhe jeton në Elbasan.

Nëna ime ka një vëlla, i cili jeton në Preshevë. Unë flas shqip dhe mësoj frëngjisht në shkollë.



Mua më pëlqen vendi ku jetoj. Njerëzit janë dashamirës. Natyra është magjepsëse.

Këtu jam miqësuar me shokë dhe shoqe.

Ja, shoqja ime e ngusht është Klodí. Ajo është moshatare me mua.

Ajo është rritur në ajrin e pastër të Alpeve të Zvicrës. Është zvicerane, flet germanisht dhe mëson frëngjisht. Ne flasim frëngjisht me njëra-tjetrën. Shoku im i bankës quhet Kevini.

Ai është nga Amerika. Është amerikan dhe flet anglisht dhe frëngjisht. Albani është kushëriri im, ai është 13-vjeçar. Ai jeton në Bern, në kryeqytetin e Zvicrës. Është shqiptaro-zviceran dhe flet tri gjuhë: gjermanisht, shqip dhe frëngjisht. Unë dhe Albani flasim shqip kur jemi bashkë, por të tjerët nuk na kuptojnë. Unë jam krenare që jam shqiptare dhe që jetoj në një vend të bukur.



#### **Kosova**

Sipërfaqja: 10 887 km<sup>2</sup>.

Banorë: rreth 2 milionë.

Kryeqyteti: Prishtina

Qytetet më të mëdha: Prizreni,

Peja, Gjakova, Mitrovica, Gjilani,

Ferizaj dhe Vushtrria.

Dita e pavarësisë: 17 shkurt 2008.



#### **Zvicra**

Sipërfaqja: 41 285 km<sup>2</sup>.

Banorë: mbi 7 milionë.

Kryeqyteti: Berni.

Qytetet më të mëdha: Cyrihu, Bazeli,

Gjeneva, Llozana, Friburgu dhe Lucerni.

Dita e pavarësisë: 1 gusht 1291.

## Aktivite

### 1) Ta kuptojmë mësimin e kaluar



1. Unë quhem \_\_\_\_\_  
Unë jam nga \_\_\_\_\_  
Unë flas \_\_\_\_\_  
Unë mësoj \_\_\_\_\_

3. Klodi është nga \_\_\_\_\_  
Ajo është nga \_\_\_\_\_  
Ajo flet \_\_\_\_\_  
Ajo mëson \_\_\_\_\_



2. Kevini është nga \_\_\_\_\_  
Ai është \_\_\_\_\_  
Ai flet \_\_\_\_\_



4. Albani është nga \_\_\_\_\_  
Ai është \_\_\_\_\_  
Ai flet \_\_\_\_\_

### 2) Analizojmë

1. Kush flet në këtë tekst? \_\_\_\_\_
2. Ku jeton Gentiana? \_\_\_\_\_
3. Përse i pëlqen Gentianës vendi ku jeton? \_\_\_\_\_
4. Çka thotë ajo për Kosovën? \_\_\_\_\_
5. Sa është larg Kosova nga vendi ku jeton? \_\_\_\_\_

### 3) Thellohemi

6. Cilat gjuhë dhe dialekte i di ti? \_\_\_\_\_
7. Cilat gjuhë fliten në lagjen ku banon? \_\_\_\_\_
8. Sa herë është më i madh se Kosova vendi ku jeton? \_\_\_\_\_
9. Cilën gjuhë do të doje ta mësoje më së shumti dhe pse? \_\_\_\_\_

### 4) Përktheni këto fjalë në gjuhën e vendit ku jetoni!

Vend \_\_\_\_\_

kombësi \_\_\_\_\_

gjuhë \_\_\_\_\_





*Nihat Beqiri: Buka (pikturë)*

#### 4. Shtëpia ime

Unë jam Agroni. Jetoj në fshat, në një shtëpi me **kopsht** të gjelbëruar e plot me lule të bukura. Shtëpia ime është dykatëshe e gjysmë. Nga **dera e hyrjes** kalohet në një **korridor** të gjërë. Në të **djathtë** është një **banjë** e madhe, kurse në të **majtë** gjendet një **tualet** për mysafirët.

Në **katin përdhesë** kemi **dhomën e pritjes** me **dy dritare** të mëdha, e cila është e mobiluar me një **kanape**, **dy kolltuqe**, një **tavolinë të ulët** dhe një **televizor**. Në këtë kat është edhe **kuzhina**, në të cilën gjendet një **tryezë** me një **mbulesë** të bardhë dhe me gjashtë **karrige**. Mbi tryezë janë vendosur **pjatat**, **pirunët**, **lugët e thikat**. Nga ana e kopshtit kemi një **tarracë** me tavolinë e karrige dhe një **ombrellë** të madhe dielli.

Në **katin e parë** kemi tri **dhoma të fjetjes**. Njëra është për mua dhe vëllanë tim, tjetra për motrën dhe e treta për prindërit.

Nën **kulm** gjendet një dhomë fjetjeje për mysafirët dhe një dhomë mësimi, ku kemi një tavolinë pune me një kompjuter. Mbi kulmin e shtëpisë qëndron **oxhaku** dhe një **antenë televizori**, me të cilën kapim programet nga Atdheu.

Shtëpia jonë ka edhe një **bodrum** të gjërë. Në të gjenden **garazhi i automobil**, **kthina për larjen dhe tharjen e rrobave** dhe kthina ku është i vendosur **instalimi i ngrohjes qendrore**.

## Aktivite

### 1) Ta kuptojmë tekstin: Përgjigjuni pyetjeve me gojë a me shkrim!

1. Ku jeton Agroni? \_\_\_\_\_
2. Sa katëshe është shtëpia e Agronit? \_\_\_\_\_
3. Çka gjendet në katin përdhësë? \_\_\_\_\_
4. Çka në katin e parë? \_\_\_\_\_
5. Çka gjendet nën kulm? \_\_\_\_\_
6. Çka gjendet në bodrum? \_\_\_\_\_
7. Ku gjendet oxhaku dhe antena e televizorit? \_\_\_\_\_
8. Sa anëtarëshe është familja e Agronit? \_\_\_\_\_

### 2) Plotëso me shkrim!

Ku jeton ti? (rretho)                      Në qytet              Në fshat              Në banesë              Në shtëpi

Sa katëshe është shtëpia jote/pallati ku banon ti? \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Sa dhomëshe është banesa apo shtëpia jote? \_\_\_\_\_

Cilat janë dhomat e shtëpisë apo të banesës sate? \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Cilat mobilie keni në dhomën e pritjes? \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Ku mëson dhe ku i kryen ti detyrat e shtëpisë? \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Përshkruaje shtëpinë e gjyshërve/prindërve në Atdhe e pastaj vizatoje atë!

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

## 5. Në lagjen time



**Iliri:** Unë jetoj gjithmonë në fshatin tim të bukur. E njoh shumë mirë lagjen time.

Banoj në një shtëpi njëkatëshe. Ajo gjendet rrëzë një pylli. Në hyrje të fshatit është shkolla dhe pak më tutje është tregu i gjelbër. Në të djathtë do ta shihni kishën e Shën Gjergjit, e cila është ndërtuar në shekullin e 15-të. Në fund duket biblioteka.

**Zana:** Unë që prej 12 vjetësh jetoj në qytet. Banoj në lagjen “Flora” në një ndërtesë shumëkatëshe. Banesa ime është në katin e 10-të, numër 41. Te ne, kati i parë është “kati përdhësë” dhe kati i dytë numërohet si kati i parë, kështu vazhdohet deri në katin e 13.

**Iliri:** A e njeh ti lagjen tënde?

**Zana:** Unë nuk e njoh krejt lagjen time. Por ja disa qendra të rëndësishme.

**Iliri:** Sa mirë që keni liqen!

**Zana:** Po, Ilir. Uji i liqenit është i kaltër dhe i pastër. Kur mbarojmë mësimet, ne fëmijët e lagjes dalim anës së liqenit. Aty e përkujtojmë se si kemi kaluar së bashku në shkollë. Kur është vapë disa zhytemi në liqen, sepse dimë të notojmë mirë. Nganjëherë lundrojmë me varkë mbi valë. Çdo ditë jemi bashkë me Kimberlej nga Afrika e Jugut, Bujari nga Shqipëria, Mathiasi nga Kameruni, Lea nga Italia, Aliu nga Turqia dhe Aja nga India.. Unë kam një shoqe të ngushtë. Ajo quhet Hajdi. Është nga Zvicra. I ka flokët e verdhë e sytë të gjelbër. Vishet me xhinsi dhe është e dashur. I pëlqejnë shumë vizatimi dhe muzika. Thotë se do të bëhet piktore.




Shkolla



Spitali



Kisha




Kështjella



Xhamia



Biblioteka



Parku



Posta



Liqeni



Aeroporti



## Aktivite

### 1) Përgjigju pyetjeve me gojë a me shkrim!

Si quhet vendi ku banon? \_\_\_\_\_

A banon ti në ndërtesë apo në shtëpi? \_\_\_\_\_

Si quhet vendi i lagjes sate? \_\_\_\_\_

Në cilin kat banon? \_\_\_\_\_

Çfarë lloji të shtëpive janë në lagjen tënde? \_\_\_\_\_

Cili është numri i banesës apo shtëpisë sate? \_\_\_\_\_

Sa kohë jetoni në vendbanimin tuaj? \_\_\_\_\_

A e njeh ti lagjen/komunën tënde mirë? \_\_\_\_\_


Kush banon në lagjen tënde? \_\_\_\_\_

Cilat janë qendra të rëndësishme në lagjen a në komunën tënde? \_\_\_\_\_

---

---

---



### 2) Thellohemi

Shikoni mirë dy figurat dhe jepni mendimin. Cila lagje të pëlqen më shumë? Pse të pëlqen? \_\_\_\_\_

---

---

---

Përktheni këto fjalë në gjuhën e vendit ku banoni: katund (fshat) \_\_\_\_\_



qytet \_\_\_\_\_ lagje \_\_\_\_\_ kat \_\_\_\_\_

vendbanim \_\_\_\_\_ ndërtesë/pallat \_\_\_\_\_

## 6. Festë në qytet



Dje, më 30 qershor, nxënësit e qytetit kanë festuar përfundimin e vitit shkollor. Ata kishin hapur një ekspozitë me punimet e nxënësve. Me punëdoret e tyre kishin zbukuruar muret e korridorit. Më së tepërmi u pëlqye ekspozita e Erës. Nxënësit/et shkruanin përshtypjet e tyre për ekspozitën e saj (shih poshtë). Nënëat e fëmijëve kishin gatuar ëmbëlsira të ndryshme. Nxënësit: Besa, Vivani, Xhoana dhe Patricia shitnin për arkën e klasës. Në palestër nxënësit e klasës së pestë kishin përgatitur një spektakël. Palestra ishte mbushur plot me spektatorë. Ata kishin përgatitur një pjesë të bukur teatrale. Në skenë luajtën Uendi, Xhesika dhe Simoni, të cilët imituan kafshët e pyllit. Atë ditë të gjithë dukeshin të buzëqeshur. Sidomos mësuesit/et kishin mbetur shumë të kënaqur nga kjo festë, sepse fëmijët mund të mësonin gjëra të reja. Ja disa vizatime nga ekspozita:



### Përshtypje për ekspozitën e Erës.

Era, urime për ekspozitën! Të gjitha janë të bukura! Të lumtë!

**Rona**

Era, mua më pëlqejnë shumë pikturat e tua, sidomos mulliri. Shpresoj që një ditë do të bëhesh piktore e madhe.

**Patricia**

Urime për talentin tënd të rrallë. Suksese! Shpresoj se do ta realizosh ëndrrën tënde si piktore.

**Vilmi**

Të uroj për talentin tënd. Më pëlqyen shumë pikturat e tua. Të uroj suksese.

**Anxhela**

Të përgëzoj për pikturat, në veçanti për pikturën e parë dhe shtëpinë në formën e mollës së mbuluar me borë.

**Ina**

## Aktivite


### 1) Kuptojmë

- a) Me çfarë rasti është organizuar kjo festë?
- b) Kur është organizuar?
- c) Kush ka marrë pjesë?
- ç) Si është zhvilluar?

### 2) Analizojmë

- a) Çka bëjnë për festën e tyre nxënësit, personazhe në tekstin e mësipërm? \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- b) Cilat janë përshtypjet tuaja për festën e përshkruar në tekst? \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- c) Po te ju: ku dhe si festohet përfundimi i vitit shkollor? Trego! \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

3) **Thellohemi.** Shkruaj numrin e fjalisë që i përgjigjet fotografisë. 1. Çfarë dëshironi të pini? 2. A vjen të vallëzojmë? 3. A luajmë së bashku? 4. Mos shkoni! Unë do të mbes vetëm. 5. Ju lutem, rrini edhe pak! 6. Mirupafshim! Faleminderit! Do të shihemi përsëri.





## 7. Në bibliotekë



Flora, Albani, Martina dhe Johani janë nxënës/e të një klase. Ata çdo të mërkurë në orën dy e tridhjtë takohen në rrugën e bibliotekës shumëkulturore.

Albani erdhi sot duke vrapuar.

**Martina:** Ku je, more Alban? Ti gjithmonë vonohesh!

**Albani:** Unë para se të nisem e ndihmoj nënën dhe banoj më larg se ti. Nëse nuk të pëlqen, mos më prit!

**Martina:** Fatbardhësisht që s'jam si ti, gjithmonë dukesh si i mërzhitur.

**Albani:** Lëre, lëre të mos grindemi për kurrgjë.

**Flora:** Edhe tri ditë e kam ditëlindjen, po ju ftoj për në orën 17. Më tregoni nesër, a mund të vini?

**Bibliotekari:** Urdhëroni! Fëmijë të dashur!

**Flora:** Ju lutem, zotëri, a keni librin "Tregime shqiptare"?

**Bibliotekari:** Besoj se po. Në bibliotekë kemi libra të ndryshëm: libra shkencorë, romane dhe revista. Librat janë në disa gjuhë: në anglisht, gjermanisht, shqip, suedisht, greqisht....

**Albani:** Unë dëshiroj libra në gjuhën shqipe.

**Bibliotekari:** Po. Cilin libër e kërkon?

**Albani:** Mua më pëlqen libri "Verorja".

**Bibliotekari:** Po. Ky libër është i mrekullueshëm.

**Albani:** Mirë, po e marr. Faleminderit!

**Martina:** Unë dëshiroj të marrë libra në gjuhën italiane.

**Bibliotekari:** Mirë, tash plotësoni skedën.

**Johani:** A keni librin "Hari Poter" në anglisht?

**Bibliotekari.** Po. Urdhëroni. Ja, këtu i keni rregullat mbi librin.



Ju lutem, kthejini librat me kohë!

- Librat i lini larg nga vëllezërit e vegjël, motrat dhe kafshët shtëpiake!
- Në libër asnjëherë mos shkruani dhe mos shkarravitni!

Para se ta merrni librin, gjithmonë pastroni duart.

- Libri shfletohet nga këndi i lartë djathtas.
- Librin ruaje nga lagështia.
- Pranë librit mos pi dhe mos ha ushqim.

## Aktivite

### 1) Ta kuptojmë mësimin e zhvilluar. Përgjigjuni pyetjeve vijuese:

Kush shkon në bibliotekë?

Ku gjenden fëmijët në fillim të tregimit?

Përse ishte Martina e shqetësuar?

Pse Albani ishte vonuar?

Kush punon në bibliotekë?

Cilin libër e mori Flora?

Çka bëri Johani?

### 2) Analizojmë.

Për çdo libër të lexuar duhet të plotësosh skedën. Plotëso skedën e librit të fundit që ti ke lexuar. Shkruaj.

Titulli i librit \_\_\_\_\_

Emri i autorit \_\_\_\_\_

Lloji i librit \_\_\_\_\_

Numri i faqeve \_\_\_\_\_

Me ngjyrat apo i bardhë/i zi \_\_\_\_\_

### 3) Thellohemi. Përgjigju pyetjeve në vazhdim.

a. Trego sa shpesh shkon ti në bibliotekë? \_\_\_\_\_

b. Në cilën gjuhë lexon? \_\_\_\_\_

c. Cilën gazetë a revistë për fëmijë e lexon? \_\_\_\_\_

ç. Cila revistë të pëlqen dhe pse? \_\_\_\_\_

d. A di ndonjë titull të revistave në gjuhën shqipe? \_\_\_\_\_

dh. A shkruan ndonjëherë vjersha apo tregime? \_\_\_\_\_

### 4) Përgatit një prezantim 7-minutësh për librin e preferuar! Tregoju shokëve/ shoqeve për çka është ky libër dhe pse e do shumë!

### 5) Përktheji këto fjalë shqipe në gjuhën e vendit ku jeton.

fatbardhësi \_\_\_\_\_ gazetë \_\_\_\_\_ revistë \_\_\_\_\_

i mrekullushëm \_\_\_\_\_ poezi \_\_\_\_\_ skedë \_\_\_\_\_

## 8. Një botë për të gjithë



- VAJZA E PARË:** Në gjithë botën ka vende me njerëz të ndryshëm. Secili popull ka kulturën, gjuhën dhe besimin në fenë e vet.
- DJALI I PARË:** Njerëzit kanë pamje të ndryshme.
- VAJZA E DYTË:** Sot udhëtimi i shpejtë bashkëkohor e ka bërë të mundur që njerëzit nga vende të ndryshme të takohen e të miqësohen me njëri-tjetrin.
- DJALI I DYTË:** Njerëzit ndryshojnë prej kafshëve, sepse ata janë në gjendje të flasin.
- VAJZA E TRETË:** Gjuha e parë që mëson një njeri të flasë quhet gjuha amtare ose gjuha e nënës.
- DJALI I TRETË:** Në vendet ku fliten shumë gjuhë ka zakonisht një gjuhë zyrtare, e cila përdoret edhe në shkollë.
- VAJZA E KATËRT:** Kur njerëzit lëvizin nga një vend të botës në një vend tjetër, ata e marrin me vete gjuhën e tyre.
- DJALI I KATËRT:** Në botë ka shumë besime. Secila fe ka besimet e veta, zakonet dhe rregullat se si besimtarët e saj duhet të sillen.



## Aktivitete

### 1) Të mësojmë rreth feve të ndryshme

#### VAJZA E PESTË: Judaizmi

Është feja e besimtarëve hebrenj dhe është një fe shumë e vjetër. Libri i tyre i shenjtë quhet **Torah**, çka i përgjegjet Dhjatës së Vjetër të Biblës së të krishterëve. Ata shkojnë në sinagogë, siç e quajnë faltoren e tyre.

#### DJALI I PESTË: Krishterimi










Të krishterët besojnë se zoti ka çuar birin e tij, Jezusin, për t'u mësuar njerëzve se si të jetojnë. Historia e tij rrëfhet në Dhjatën e Re, d.m.th. në pjesën e dytë të **Biblës**, e cila është libri i shenjtë i të krishterëve. Të krishterët luten në një kishë. Dallohen katolikë dhe protestantë, si dhe (në vendet sllave dhe në Greqi) ortodoksë.

#### VAJZA E GJASHTË: Islami

Islami është feja e besimtarëve myslimanë. Një profet, i quajtur Muhamedi nga Meka, u mësonte pasuesve të tij, myslimanëve, që të luteshin pesë herë në ditë për zotin e tyre Allahun. Libri i tyre i shenjtë quhet **Kuran**.

### 2) Përgjigjuni me gojë a me shkrim!

- Çfarë feje i përket?
- Çfarë fesh kanë shokët apo shoqet e tua?
- Vizatoni për çdo ilustrim simbolin përkatës.

Krishterimi 	Judaizmi 	Islami 
 Xhami	 Kishë	 Sinagogë
Kurani	Bibla	Torah
		



## 9. Të drejtat dhe përgjegjësitë në shkollë/në klasë

Çdo njeri në botë ka të drejtat dhe përgjegjësitë e veta. Të drejtat dhe përgjegjësitë janë si dy anët e së njëjtës medalje.

**Të drejtat** janë veprimet e një personi sipas së cilave ai mund të silltet. **Përgjegjësia** është **detyrimi** i një personi të silltet sipas ligjeve e rregullave të caktuara në shoqëri.

Shpeshherë njerëzit kërkojnë vetëm të drejtat e tyre dhe harrojnë që ata kanë edhe përgjegjësi. Ndjenja e përgjegjësisë duhet ta shoqërojë njeriun gjatë gjithë kohës. Në qoftë se njerëzit nuk i përmbushin përgjegjësitë, atëherë ata ndeshen me pasojat që vijnë prej tyre.

Edhe nxënësit/et e mësuesit/et kanë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në shkollë e në klasë. Nganjëherë edhe këta gabojnë e nuk i respektojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.

Një ditë derisa mësuesi po shpjegonte mësimin, Albani me lapsin e tij shkruante në bankën e vet. Mësuesi e pa dhe thirri me zë të lartë: „Hej, Alban, pse shkruan me laps në bankë?“ „Nuk është banka ime, mësues“, u përgjigj Albani. Mësimi u ndërpre për një çast. Pastaj ai me zë të butë e qortoi Albanin dhe e këshilloi atë dhe nxënësit/et e tjerë/a t'i ruajnë orënditë e shkollës, sepse edhe ato janë tonat. Edhe nxënësit/et i thanë mësuesit se edhe ai kishte gabuar diçka.

### Aktivitete

1) Thoni/diskutoni pse kishte gabuar Albani e pse mësuesi! Çfarë duhet të bëjnë ata pas gabimit të bërë?

2) Përktheni në gjuhën e vendit këto fjalë dhe shprehje duke i shkruar ato në fletoret tuaja.

- të drejtat \_\_\_\_\_ - përgjegjësitë \_\_\_\_\_

- ndjenja e përgjegjësisë \_\_\_\_\_

- ndeshen me pasojat \_\_\_\_\_

**3) Dalloni cilat janë të drejtat dhe cilat përgjegjësitë e nxënësve dhe shkruani ato në vendin e duhur.**

- Të na respektojnë mësuesit/mësueset.
- Të jemi të sjellshëm e të urtë.
- Të dëgjojmë mësuesin dhe të tjerët kur flasin.
- T'i tregojmë mësuesit/es çfarë ndiejmë dhe të kërkojmë ndihmë kur na nevojitet.
- Të mos dëmtojmë pajisjet dhe mobilitet e shkollës.
- Të shkojmë në tualet gjatë orës së mësimit, me lejen e mësuesit.
- Të mos na fyejnë mësuesit edhe atëherë kur gabojmë.
- Të kujdesemi që klasa të jetë përherë në rregull.
- Të mos bëjmë zhurmë kur mësuesi shpjegon mësimin.
- Të kemi kohë loje dhe argëtimi kur mbarojmë detyrat e shkollës.
- Të kemi një klasë të pastër dhe të pajisur me mjete mësimore.
- Të shkojmë në shkollë rregullisht.
- Të sillemi mirë me shokët e shoqet e klasës dhe t'u ndihmojmë atyre.
- Të mos hedhim mbeturinat jashtë vendit të caktuar.
- Të na mundësohet të mësojmë pa u penguar.
- Të kemi mundësi të zgjedhim me kë duam të ulemi në klasë.

Të drejtat tona	Përgjegjësitë tona
1.	1.
2.	2.
3.	3.
4.	4.
5.	5.
6.	6.
7.	7.
8.	8.

**4) Cilat të drejta dhe përgjegjësitë i keni në shtëpi, në familjen tuaj?**

Bëni një tabelë dhe shkruani të paktën pesë të drejta dhe pesë përgjegjësi!

**5) Informohuni në internet (shqip apo në gjuhën e vendit ku banoni) për të drejtat e fëmijëve, tregoni në klasë çka keni gjetur!**



## 10. Shëndeti ynë

Dëshira e pyeti nënën, çka kuptojmë me fjalën shëndet?

Nëna: Shëndeti nënkupton trupin tonë pa sëmundje dhe të rritur normalisht. Shëndeti varet shumë edhe prej nesh sesa ne kujdesemi për të.

- Si të veprojmë atëherë?

Nëna: Në radhë të parë duhet ushqyer mirë, veshur mirë, banimi në kushte të mira, fjetja e qetë, marrja me sport e lojëra, ta mbajmë higjienën personale dhe në banesë.


- Po unë jam e shëndoshë, nënë?

Nëna: Po, bija ime. Ti i ke kushtet e mira. E mban higjienën personale. Kjo kupton se i lan duart, dhëmbët e trupin me rregull, pren thonjtë e flokët, kreh flokët, në shkollë shkon e pastër dhe e qetë.

- Po çka duhet ngrënë më shumë?

Nëna: Ushqimet me pemë, perime, bukë e prodhimet nga drithërat janë më të shëndetshme. Duhet ta rrespektojmë piramidën e ushqimeve. Çka është poshtë në atë piramidë duhet të hamë shpesh, çka është lart vetëm rrallë.

- Unë do të jem e kujdesshme, tha Dëshira.



Piramida e ushqimeve

### Aktivitete

1) Shkruaj sipas piramidës ushqimet duke filluar nga baza e saj!

---

---

---

---

---

### Si të veprojmë për një shëndet të mirë

Me rëndësi për shëndet është ushqimi i rregullt. Në mes tyre preferohet ngrënia e pemëve dhe e perimeve. Pemët gjithmonë duhet larë para ngrënies. Nuk preferohet heqja e lëvores, e cila ka shumë vitamina. Shëtitjet në natyrë e forcojnë shëndetin tonë. Ajri i pastër i vendeve të gjelbëruara na duhet shumë. Rrezitja në diell i forcon eshtrat dhe shton vitaminat e lëkurës. Noti si sport uji e ndihmon shumë trupin tonë të jetë elastik dhe i zhvilluar mirë.

**2) Përgjigju pyetjeve vijuese!**

Nga kush varet shëndeti ynë? \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Si duhet të veprojmë për të qenë të shëndetshëm? \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Si e mbajmë higjienën personale? \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Cilat janë ushqimet e shëndosha? \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

3) Shkruaj disa fjali për shëtitjet, ditët në plazh dhe aktivitetet e tua sportive!  
Çka të pëlqen më shumë atje ku banon, çka në vendin tënd të prejardhjes (p.sh. Kosova)? \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

4) Shkruaj emrat e këtyre sendeve! Shiko në kornizën poshtë si shkruhen fjalët!



\_\_\_\_\_

**peshqiri, sfungjeri, shpuza, krehri, pasta e dhëmbëve, furça e dhëmbëve, shamponi**



## 11. Teuta dhe Iliri

Teuta dhe Iliri u kthyen nga shkolla shqipe. Përshëndetën prindërit e tyre dhe lëshuan çantat në vendin e caktuar.

- Teuta, si kaluat sot në shkollën shqipe? - pyeti babai.

- Shumë mirë, babi, – u përgjigjen Teuta dhe Iliri njëzëri.

- Çfarë mësuat sot? - pyeti e ëma.

- Sot mësuam për kuptimin e emrave tanë, nënë, – u përgjigj Teuta.

- Po ju, a i ditët? - pyeti babai.

- Agimi, Vlora, Saranda, Vjosa e Korabi i ditën kuptimin e emrave të tyre, – u përgjigj Iliri, me shpejtësi.

- Por, pati edhe të tjerë që nuk i ditën, - tha Teuta.

- Po ju, a e ditët kuptimin e emrave tuaj? - pyeti e ëma.

- Jo mami, nuk e ditëm. Na erdhi shumë keq, - u përgjigjen Teuta dhe Iliri.

- Po mësuesi nuk ua shpjegoi kuptimin e emrave tuaj? - ndërhyri babai.

- Jo, na dha për detyrë që t’ju pyesim juve, - tha Iliri.

- Mirë, - tha babai. - Pasi të hamë darkë, do t’jua shpjegoj.

Pasdarke babai dhe nëna i thirrën fëmijët e tyre pranë dhe filluan t’u shpjegonin kuptimin e emrave.

- Dëgjoni, fëmijët e mi, - foli babai. - Të parët ose paraardhësit tanë quheshin ilirë, kurse gjuha e tyre ishte ilirishtja. Prandaj në kujtim të tyre, ti dhe shumë djem të tjerë e mbajnë këtë emër.
- Po emri im, babi, çdo të thotë? - pyeti Teuta kureshtare.
- Këtë po ia lë mamit të ta shpjegojë, - tha babai.
- Eh, bija ime – shtoi e ëma, - ilirët kishin edhe mbretërit e tyre. Ata kanë qenë shumë. Ilirët patën edhe një mbretëreshë, që quhej Teutë. Pra ti e ke emrin e saj, - mbaroi shpjegimin nëna.
- Edhe emrat Dardan, Taulant, Ardian dhe Alban janë emra që vijnë nga emrat e fiseve ilire, të cilat thuhet se ishin gjithsej 72, - shtoi babai në fund.
- Sa të lumtur që jemi, o mami e baba, që mësuam kuptimin e emrave tanë e që paskan prejardhje të vjetër ilire – tha Iliri.
- Sa do të ndihemi mirë, që në orën e ardhme do të dimë t’u tregojmë mësuesit, shokëve e shoqeve për kuptimin e emrave tanë, – mbylli bisedën Teuta.
- Ndërkaq Teuta dhe Iliri biseduan: Vallë do t’i dinë shokët e shoqet tona: Dardani, Taulanti, Ardiani, Genti, Bardhyli, Shkodrani e të tjerët t’i shpjegojnë emrat e tyre?

### Aktivitete

#### 1) Lexojeni tekstin sipas roleve duke shkruar me laps para vizës lidhëse inicialet:

T (për Teutën ),      I ( për Ilirin),      B (për babën),      N (për nënën)

#### 2) Pyetni mësuesin/en për fjalët që nuk i kuptoni dhe shkruani ato në gjuhën shqipe e të vendit.

1. \_\_\_\_\_ 2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_ 4. \_\_\_\_\_
5. \_\_\_\_\_ 6. \_\_\_\_\_

#### 3) Çfarë kishin mësuar Teuta dhe Iliri atë ditë në mësimin e gjuhës shqipe? \_\_\_\_\_

---



---



---



**4) Po ju a e dini kuptimin e këtyre emrave:**

Emri Agim vjen nga fjala \_\_\_\_\_

Emri Vlorë vjen nga \_\_\_\_\_

Emri Sarandë vjen nga \_\_\_\_\_

Emri Vjosë vjen nga \_\_\_\_\_

Emri Korab vjen nga \_\_\_\_\_

Nga vjen emri Ilir? \_\_\_\_\_

Nga vjen emri Teutë? \_\_\_\_\_

Po nga vjen emri yt? \_\_\_\_\_

A mund të shpjegosh edhe ca emra të tjerë nga familja jote? \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Detyrë: Pyetni së pari prindërit e pastaj edhe mësuesin/en për kuptimin e emrave:**

**Dardan** \_\_\_\_\_

**Taulant** \_\_\_\_\_

**Ardian** \_\_\_\_\_

**Gent** \_\_\_\_\_

**Bardhyl** \_\_\_\_\_

## 12. Dhurata e ditëlindjes



**Petriti:** Ditën e shtunë Aja ka ditëlindjen. Ne duhet të shkojmë tek ajo.

**Klodi:** Duhet t' i blejmë një dhuratë.

**Teo:** Patjetër.

**Petriti:** Nesër të gjithë së bashku po shkojmë në qytet.

**Rina:** Për çka do të gëzohet Aja?

**Klodi:** Po, asaj i pëlqejnë shumë gjëra: libra të mirë, orë dore, DV, CD, stilograf, llëmbë, byzylyk, bllok adresash, bluzë etj.

**Petriti:** Libri është një dhuratë e mirë për ditëlindje.

**Teo:** Ai është më i mirë se gjërat e tjera.

**Rina:** Po për një shishe parfum? Asaj i pëlqen shumë.

**Vimili:** Kjo është një dhuratë e shtrenjtë.

**Alin:** Aja e pëlqen muzikën, prandaj po ia blejmë një CD.

Të nesërmen fëmijët takohen. Ata dëshirojnë të blejnë një dhuratë për ditëlindjen e Ajës. Së pari hynë në dyqanin e dhuratave. Ata nuk mund t' i gjenin të gjitha gjërat në një vend dhe kërkuan në dyqane të tjera. Kaluan më shumë se dy orë për të gjetur atë që dëshironin. Më në fund blenë disa gjëra dhe përgatitën një pako të vetme. Ata ishin të lumtur me dhuratën që e kishin përgatitur.

- Urime për ditëlindje, Aja! Kjo dhuratë është për ty.
- Hmm... ç' është kjo?
- Në të ka një orë dore, një gjerdan, një byzylyk, një stilograf, një unazë, rruaza dhe një zinxhir.
- Më pëlqejnë. Shumë faleminderit!

## Aktivite

### 1) Përgjigju me gojë ose me shkrim pyetjeve vijuese!

- Si e menduan fëmijët e klasës dhuratën për ditëlindjen e shoqes së tyre?
- Ku shkuan ata?
- Në cilin dyqan shkuan fillimisht?
- Po Aja çfarë u tha?

### 2) Të analizojmë!


- Ritregoni përmbajtjen duke u mbështetur në këto pika:

Hyrja: Petriti...

Zhvillimi: fëmijët në qytet

Mbyllja: dhurata

- Me cilat gjëra fëmijët përgatitën dhuratën për ditëlindjen e shoqes së tyre?



### 3) Thellohemi

Cilët janë personazhet e këtij teksti? \_\_\_\_\_

Cila është tema e këtij teksti? \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

- Përshekruani në një fletë të veçantë se cilat janë dëshira tuaja më të mëdha për ditëlindjen e ardhshme! Bëni dy ndarje: a) dëshira që mund të realizohen, b) dëshira që për fat të keq nuk do të plotësohen.

### 13. Të kujt janë këto rroba?



**Era:** Të kujt janë këto rroba, mami?

**Mami:** Këto janë të miat.

**Era:** Të lutem, më jep t'i shoh.

**Mami:** Po, shikoji.

**Era:** O, sa të bukura janë. Vishi, t'i shoh si po të rrinë!

**Mami:** Ja!

**Era:** Mami, ju rrinë shumë bukur. Ju kanë hije, bluza e kaltër dhe fundi i përhirtë.

**Era:** E këto për kë janë, mami?

**Mami:** Janë për Bujarin, xhinset, një xhemper, brekë, nënkëmishë, puma, shalli.

**Era:** Sa të mirë qenkan. Sa do t'i pëlqejnë Bujarit.

**Mami:** Patjetër.

**Era:** E kjo, mami, a është për mua?

**Mami:** Jo. Këmisha, kostumet (setër e pantallona), manteli, pizhamat, kravata, këpucët, kapela, rripi janë për Arsimin, d.m.th. për babin.

**Era:** E për mua çka ke blerë?

**Mami:** Ty këtë radhë të kam blerë një fustan të kuq, sandale, çorapë të gjatë.

**Era:** Si bëhen rrobat e reja, mami?

**Mami:** Dikur moti rrobat janë bërë me dorë. Sot shumica e rrobave të reja bëhen me makina. Këto janë të lehta për t'u larë, të lira dhe të rehatshme.

**Era:** Si vishen njerëzit?

**Mami:** Njeriu vishet sipas klimës. Kur është nxehtë, vishet me rroba të lehta. Kur është ftohtë, me rroba të trasha. Kur është në punë, vishet me rroba pune. Kur bën sport, me rroba sportive. Kur shkon në festë, me rroba të festës.

**Kujdes! Rrobat vishen. Këpucët dhe çorapët mbathen. Kravata dhe kapela vihen.**



## Aktivite

### 1) Përgjigju pyetjeve vijuese!

- a) Për çka flet teksti? \_\_\_\_\_
- b) Çfarë rrobash kishte blerë Mamaja e Erës për vete? \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- c) Çfarë për Bujarin? \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- ç) Çfarë për babin? \_\_\_\_\_
- d) Çfarë për Erën? \_\_\_\_\_

### 2) Analizojmë

- a) Si punoheshin rrobat dikur? \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- b) Si bëhen tash? \_\_\_\_\_
- c) Si quhet kostumi tradicional i një vendi? \_\_\_\_\_
- ç) Si vishet njeriu? \_\_\_\_\_
- d) Çfarë rrobash të tjera kemi? \_\_\_\_\_

### 3) Thellohemi

- a) Po ti çka ke veshur sot? \_\_\_\_\_
- b) Cilat janë veshjet e tua të preferuara? \_\_\_\_\_



### 4) Trego si janë veshur këta fëmijë?

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_
- ç) \_\_\_\_\_

## 14. Mjedisi jetësor

Çka kuptojmë me mjedisin jetësor?

Shikojini fotografitë dhe bisedoni rreth kësaj pyetjeje!



**Mjedisi jetësor** është çdo gjë që na rrethon, çdo gjë me të cilën kemi kontakte gjatë jetës. Shtëpia, oborri, lagjja, fshati, qyteti, fushat, arat, malet, lumenjtë, liqenet, detet janë mjedise ku zhvillohet jeta.

Toka (dheu), uji dhe ajri paraqesin shtëpinë e qenieve të gjalla, siç janë: njeriu, kafshët dhe bimët. Ato jetojnë në harmoni njëra me tjetrën dhe janë të lidhura mes vetes me ushqimin, shumimin dhe përhapjen e tyre. Kjo harmoni duhet ruajtur. Çdo ndërhyrje nga njeriu e prish harmoninë dhe dëmton jetën e organizmave.

### **Ruaje rrethin tënd!**

Çdo hedhje e mbeturinave pa kontroll shkakton ndotje. Uji ndotet nga kimiket industriale, ajri nga tymi dhe djegiet e vajrave kimike. Nga ndotjet shkaktohen sëmundje të ndryshme, në mesin e tyre edhe epidemi të rrezikshme. **Epidemia** përhapet nga i sëmuri te te tjerët shpejt dhe është e rrezikshme për popullatën.

### **Aktivitete**

1) Shkruaj në një fletë të veçantë se çka sheh në tri pamjet e dhëna më lart!

2) Bisedoni së bashku çfarë mund të jetë domethënia e secilës prej pikave vijuese:

kujdesi ndaj luleve, mbeturinat në shportë, dëmtimi i luleve, dëmtimi i gjetheve, thyerja e degëve, frikësimi i shpendëve, ndezja e zjarrit, shuarja e zjarrit, frikësimi i shtazëve, ushqimi i shtazëve, ushqimi i shpezëve, prerja e drunjtëve, këputja e luleve

3) Zgjidh tri prej atyre pikave dhe shkruaj për ato tri pika nga 3-4 fjali!

4) Shkruaj nga një fjali për secilën prej pesë pamjeve që i sheh këtu!



- a \_\_\_\_\_.
- b \_\_\_\_\_.
- c \_\_\_\_\_.
- ç \_\_\_\_\_.
- d \_\_\_\_\_.

5) Shkruaj cilat janë disa nga mjediset jetësore! \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

6) Përshkruaj se si sillesh në ruajtjen e ambientit! \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

7) A e di ti vendin përkatës për ato mbeturina? Shkruaj!

qelq: \_\_\_\_\_ plastikë: \_\_\_\_\_

letër: \_\_\_\_\_ metale: \_\_\_\_\_

mbetje organike: \_\_\_\_\_ shishe pvc: \_\_\_\_\_

8) Detyrë: Përkthej këto fjalë në gjuhën e vendit ku banon!

mjedis \_\_\_\_\_ mbeturina \_\_\_\_\_

ndotje \_\_\_\_\_ ruajtja e mjedisit \_\_\_\_\_



## 15. Pemët dhe perimet



Ne jetojmë në bashkësi me bimë dhe me kafshë. Prej bimëve, pemët dhe perimet janë me vlerë për jetën tonë. Ato prodhojnë ushqime për ne: sheqer, proteinë, yndyra, vitamina dhe minerale. Këto janë materiet kryesore ushqyese të shtazëve dhe të njeriut.

**Pemët** janë shumë: molla, dardha, kumbulla, banania, fiku, portokalli, limoni, luleshtrydhja, rrushi, kivi, arra, kajsia, ftoi, mushmolla, ananasi, shega, mandarina etj.

### Aktivitete

**Perimet** zakonisht kultivohen me kujdes në kopsht, kërkojnë ujë dhe përkujdesje të lartë nga kopshtari. Ka shumë lloje perimesh: trangulli, domatja, patatja, karota, speci, patëllxhani, qepa, hudhra, preshi, kungulli, fasulja, bizelja, lakra, lulelakra, sallata, majdanozi.

1) Shtoni pemë apo perime të harruara në këto lista! \_\_\_\_\_

2) Shkruaji emrat e këtyre pemëve dhe të perimeve shqip dhe në gjuhën e vendit ku jeton!



\_\_\_\_\_



\_\_\_\_\_



3) Shkruaj se cilat pemë dhe perime për ty janë më të shijshme! \_\_\_\_\_

**Ushqimi me pemë e perime - burim i shëndetit**

Që të ushqehemi mirë duhet njohur bimët, përdorimin dhe ruajtjen e tyre.

Përpunimi i tyre sot në industrinë ushqimore është mjaft i përparuar.

Për rritje të shëndetshme, duhet ngrënë bukë, prodhime drithërash, perime e pemë të freskëta. Ushqimet e tjera duhet ngrënë më pak. Spërkatja e bimëve me materie kimike për mbrojtje nga sëmundjet dhe nga parazitët e dëmton kualitetin e tyre, andaj bio-prodhimet sot janë më të preferuara.

4) Mendo e shkruaj në tabelën e mëposhtme se ku rritet secila nga këto pemë e perime!



rriten në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni

rriten në vendin ku ti jeton


5) Në sa dhe në cilat forma përdoret speci për ushqim në familje?

Përdor fjalët *i freskët, në sallatë, turshi, i fërguar, i terur, në formë:*

---



---

## 16. Kafshët në natyrë

Pjesë e natyrës janë edhe kafshët. Ato janë gjallesa që lëvizin në formë aktive me gjymtyrët e tyre. Kjo u duhet për të kërkuar ushqimin dhe kontakte me organizmat e tjerë. Tri janë hapësirat ku jetojnë kafshët: dheu, ajri e uji. Kafshët mund të jenë shumë të vogla, por edhe shumë të mëdha. Ja disa prej tyre:

balena



shqiponja



kërmilli



### Aktivitete

1) Përgjigju pyetjeve vijuese!

a) Ku jetojnë balena, shqiponja dhe kërmilli? \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

b) Shkruaj çka di për balenën! \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Kafshët bimëngrënëse:** gjedhi, delja, dhia, balena, deveja, zebra, elefanti, kali, gomari, gazela kanguri etj. Shkruaj ndonjë të harruar! \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ **Kafshët mishngrënëse:** ujku, tigr, krokodili, ariu, luani, qeni, macja, dhelpra, delfini, pinguini, foka, leopardi, huti, shqiponja, skifteri, pulëbardha etj. Shkruaj ndonjë të harruar! \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

### Kafshët janë të dobishme në natyrë

Kafshët janë organizma konsumues. Ato i konsumojnë materiet ushqyese. Në pyjet tona jetojnë shumë lloje shtazësh. Disa nga ato janë në rrezik të zhdukjes. Ato kanë nevojë për kujdesin tonë. Në bjeshkët e Sharrit jetojnë shumë pak arinj, rruqebuj, ujq, derra të egër, dhelpra, shqiponja, hutinë etj.

Llojet e shtazëve formojnë zinxhir ushqimi. Zhdukja e një lloji e shkakton zhdukjen ose pakësim e llojeve të tjera në natyrë. Njeriu kujdeset duke i mbrojtur llojet e rrezikuara. Për këtë janë krijuar rezervate të mbrojtura nga ndikimi i njeriut.

2) Përmblihdh në disa fjali çka ke mësuar (apo çka që ke ditur!) për kafshët! \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

3) Shkruaj shqip dhe në gjuhën e vendit ku jeton emrat e kafshëve!



\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

4) Shkruaj emrat e kafshëve që i ke parë në natyrë apo në kopsht zoologjik! \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

5) Sajo një poezi apo një tregim të shkurtër për kafshën tënde të preferuar!

Krijo një fletë të bukur me tekstin tënd dhe me një vizatim!

*ose*

Informohu nga librat apo interneti për një kafshë e cila të intereson shumë.

Përgatis një prezantim 10-minutësh për klasën tënde, me një poster a pllakat dhe

me një ligjeratë të vogël për atë kafshë!

*Gani Gashi:  
Shqipet (Pikturë)*







## 17. Stinët e vitit

Njëherë të katër stinët biseduan për të mirat që i sjellin njeriut.

- Unë, - tha pranvera, - njerëzve u sjell gëzim, diell, lule e gjelbërim. Bashkë me mua vijnë edhe zogjtë shtegtarë: dallëndyshja, lejleku, bilbili e qyqja. Kur vij unë, qielli mbushet me flutura shumëngjyrëshe e me bletët punëtore. Me një fjalë, me mua ngjallet e gjithë natyra, zgjohen nga gjumi të gjitha qeniet e gjalla.

- Edhe unë nuk mbetem prapa, o pranverë e bukur, - foli vera. - Me vapën time unë i pjek grurin, qershitë e dredhëzat e disa perime. Kur vij unë, fëmijët shkojnë në pushime verore e lahen në ujin e ngrohtë të detit. Ata, me prindërit e vet, vizitojnë të afërmit e tyre në Atdhe.

- Mos kujtoni se m' i morët të gjitha, - foli shpejt vjeshta. - Unë i jap njeriut shumë fruta të shijshme, rrushin, mollët, dardhat, arrat, gështenjat etj. Unë i jap njerëzimit edhe misrin e pambukun. Kur vij unë, oborret e shkollave gumëzhijnë nga zërat gazmorë të nxënësve, që i kthehen shkollës, pas pushimeve verore.

- Pritni, pritni, moj motra! Edhe unë u sjell gjëra të mira njerëzve. Unë u sjell borën, mbi të cilën fëmijët kënaqën duke rrëshqitur me saja e me ski. Me borë ata bëjnë edhe dordolecin. Unë u sjell njerëzimit festat e fundvitit, Krishtlindjet dhe Vitin e Ri e bashkë me to edhe dhurata të shumta.

Stinët e mbaruan bisedën duke u kuptuar se të gjitha janë të mira dhe të gjitha i sjellin njerëzimit të mirat e tyre.



## Aktivitete

1) Lexojeni tekstin duke e ndarë në katër role.

2) Përgjigjuni pyetjeve vijuese me gojë apo me shkrim:

Për çka biseduan katër stinët? \_\_\_\_\_

Çka u sjell pranvera njerëzve? \_\_\_\_\_

Çka sjell vera? \_\_\_\_\_

E çka sjell vjeshta? \_\_\_\_\_

Po dimri çka i sjell njerëzimit? \_\_\_\_\_

Cila stinë të pëlqen ty më së shumti dhe pse? \_\_\_\_\_

3) Gjëgjëza

JANË TRI MOTRA E NJË VËLLA, DITË MË SHUMË ASNJË NUK KA.

Thuani ç'është kjo? \_\_\_\_\_

Cilat janë motrat e cili është vëllai. Pse? \_\_\_\_\_

4) Shkruaj muajt e çdo stine!

Pranvera \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Vjeshta \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Vera \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Dimri \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**5) Dalloji stinët në këtë tekst:**

Janë tri shoqe e një shok. Një sjell lule e freski (\_\_\_\_\_); njëra grurë e nxehtësi (\_\_\_\_\_); tjetra fruta mban në dorë (\_\_\_\_\_); shoku i tyre shi e borë (\_\_\_\_\_).

**6) Lexo këto fjali dhe nënvizo me me ngjyrë të kaltër cilat i përkasin pranverës, me ngjyrë të kuqe cilat i përkasin verës, me ngjyrë bojë kafe cilat i përkasin vjeshtës dhe me ngjyrë të verdhë cilat i përkasin dimrit!**

Bie borë e bën ftohtë. Dielli rrezon e bënë vapë e madhe. Lulet çelin e pemët lulëzojnë. Piqet rrushi, arrat e gështenjat. Zogjtë shtegtarë kthehen përsëri. Piqen qershitë, dredhëzat e korret gruri. Fëmijët bëjnë dordolecin e rrëshqasin me saja e me ski. Gjethet bien e zogjtë shtegtarë ikin në vendet e nxehta. Festohen festat e Krishtlindjes dhe e Vitit të Ri. Korret misri e vilet pambuku. Shkojmë në pushime verore. Qielli mbushet me flutura shumëngjyrëshe. Fillon viti i ri shkollor. Të rriturit e fëmijët marrin dhurata. Lahemi në ujin e ngrohtë të detit e të liqenit. Të gjitha qeniet e gjalla zgjohen nga gjumi dimëror.

**7) Mundohuni t'i përktheni fjalitë nga numri 6) në gjuhën e vendit ku jetoni!**

**8) Nga 12 muajt e vitit këta tre prej tyre kanë emra të pastër shqip: shkurti, qershori dhe korriku. Pse? Pyetni prindërit apo mësuesin. Po emrat e disa muajve të tjerë mund t'i shpjegoni?**

## 18. Jeta e përbashkët

*Jetë e përbashkët në livadhe*



*Jetë e përbashkët në ujëra*



Natyra është një **bashkësi e madhe** e të gjitha bimëve, shtazëve dhe njeriut. Këtyre ndryshe u themi **qenie të gjalla**. Ato jetojnë së bashku. Njeriu është **pjesë** e bashkësisë jetësore. Njerëzit jetojnë në vendbanime: **qytete** e fshatra dhe në grupe **nomadesh**. Nomadet nuk kanë **shtëpi** por jetojnë duke lëvizur në natyrë.

Njerëzit jetojnë në **harmoni** njëri me tjetrin dhe e **ndihmojnë** njëri-tjetrin. Të gjitha të mirat materiale i **shkëmbejnë** përmes tregtisë e ndihmave të tjera.



### Njerëzimi - një bashkësi e afërt

Njeriu zbuloi shumë gjëra me rëndësi, ndër të cilat ishin mjetet e trafikut dhe të komunikimit. Ato u përsosën aq shumë sa kontaktet në mes njerëzve u shtuan shumë. Sot nuk është larg asnjë skaj i kontinentit. U përsosën udhëtimet me **tren, anije, automobil dhe aeroplan**, të cilat i afruan popujt e kulturat e tyre.



## Aktivite

1) Përmblihdh çka ke mësuar në tekstin e faqes së mëparme! \_\_\_\_\_

---

---

---

2) Shkruaji emrat e këtyre mjeteve të komunikimit modern (shih fotografitë në faqen e mëposhtme) shqip dhe në gjuhën e vendit ku jeton! \_\_\_\_\_

---

---

---

Mjetet e komunikimit telefoni, **radioja, televizori, interneti dhe sistemi i navigimit** tash janë gjithkund. Ato i ofrojnë informimet dhe kontaktet me njerëz. Derisa dikur pritej një letër nga lurbeti disa muaj, tash e kemi mundësinë e komunikimit duke folur dhe duke u parë për çdo ditë.



3) Me çka dhe në cilën gjuhë komunikon me njerëzit e tu në vendlindje? \_\_\_\_\_

---

---

4 Me çka dhe në cilën gjuhë komunikon ti me shokët dhe shoqet e tua? \_\_\_\_\_

---

---

5) Shkruaj nga një fjali për secilin mjet të komunikimit!

fluturimi-aeroplan / lundrimi-anije / udhëtimi-treni/

1. \_\_\_\_\_ 
2. \_\_\_\_\_ 
3. \_\_\_\_\_ 



## 19. Jeta dikur dhe sot

Njerëzit nuk kanë jetuar dikur ashtu si jetojnë sot. Dikur ushqimin e siguronin nga gjuetia. Ata i zhvilluan veglat e gjuetisë e më vonë veglat e punës. Filluan zbutjen e kafshëve: qenit, dhisë, deles, gjedhit, kalit, lepurit, pulës, rosës, pëllumbit etj. Rrobat e veshjes i siguronin me lëkurën e shtazëve të gjuajtura. Ushqimet i merrnin të gatshme në natyrë. Tash njeriu i ka veglat e punës. I kultivon drithërat, pemët e perimet, i rrit shtazët në stalla. Tash mundësia për prodhim është shumë herë më e madhe.

### Aktivitete



1) Shkruaj si sigurohej ushqimi! \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_



2) Shkruaj si banohej! \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_



3) Shkruaj si visheshin dikur! \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_



Për nevoja të punëve në bujqësi, dikur duheshin shumë punëtorë. Familjet ishin të mëdha dhe me shumë fëmijë. Shtrati i fjetjes ishte një dyshek i mbushur me kashtë, mbi të cilin flinin disa veta.



Tash jetohej në familje të vogla. Me pagën mujore sigurohet ushqimi dhe veshmbathja. Fjetja bëhet në krevatin e butë nga materiali i përshtatshëm.

**4) Përkthe këto fjalë në gjuhën e vendit ku jeton!**

qumësht \_\_\_\_\_ rroba \_\_\_\_\_ rosë \_\_\_\_\_  
 drithëra \_\_\_\_\_ gjueti \_\_\_\_\_ gjedh \_\_\_\_\_

**Korrja dhe shirja**

Edhe format e kultivimit të drithërave, si ushqimi kryesor, u zhvilluan vazhdimisht. U shtuan varietetet e drithërave dhe u përmirësua punimi i tyre.

Dikur drithërat korreshin me *drapër* e *kosë* kurse tash me *kombajnë*.

		
 drapri	 kosa	kombajna

Nga drithërat merren frytet në formë kokrrë të cilat bluhen, bëhen miell. Mielli i grurit është ushqimi tradicional i njerëzimit.

**5) Shkruaj çka prodhohet dhe gatuhet nga mielli! Pyete edhe nënën! \_\_\_\_\_**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Jeta dikur dhe sot në familjen tënde**

Edhe në familjen tënde ndihet ndryshimi i kohës dhe zhvillimi i teknikës etj. Me siguri fëmijëria e stërgjyshërve dhe e gjyshërve të tu ndryshon shumë nga fëmijëria jote!

**6) Pyeti gjyshin, gjyshen dhe prindërit se cilat janë dallimet më të mëdha midis kohës kur ata kanë qenë fëmijë dhe kohës së tashme! Bëj një tabelë dhe prezantoje atë në klasë:**

	... kur gjyshi dhe gjyshja ishin fëmijë	... kur nëna dhe babai ishin fëmijë	Sot
Si kalohej koha e lirë			
Si kanë lëvizur njerëzit			



## 20. Pse jemi të ndarë?

Mësuesi hyri në klasë. Kësaj radhe, pos mandolinës që e mbanë përherë me vete, kishte marrë edhe një hartë. Pasi e shpalosi atë, filloi bisedën me nxënës, duke i pyetur se nga vijnë ata dhe familjet e tyre dhe duke e gjetur në hartë shtetin dhe vendlindjen.

- Albani tregoi se vjen nga Kosova, Teuta tha se vinte nga Presheva, Saranda vinte nga Tetova, Arbnora tregoi se vjen nga Shqipëria dhe Malsori tha se vinte nga Ulqini.

- Pra, a shikoni, nxënës të dashur, - vazhdoi mësuesi, - të gjithë ne jemi shqiptarë, por vijmë nga pjesë të ndryshme të Atdheut tonë etnik, nga Kosova, Shqipëria, pjesa shqiptare në Maqedoni, pjesa shqiptare në Mal të Zi dhe pjesa e mbetur në Serbi. Madje, nxënës të dashur, shumë shqiptarë jetojnë edhe në pjesën shqiptare në Greqi, që quhet Çamëri. Kur u pushtuan tokat shqiptare nga turqit e serbët, shumë shqiptarë shkuan në Kalabri të Italisë e në Turqi, ku jetojnë edhe sot. Shqiptarët e migruar në Italinë e Jugut, pas vdekjes së Gjergj Kastriotit në vitin 1468, quhen arbëreshë.

- Po pse jemi të ndarë, zoti mësues? – pyeti Shqiponja me interesim.

Mësuesi, kësaj radhe kishte vendosur t'ua zgjojë ndjenjat përmes këngës: **Pse jemi të ndarë.** Ua shpërndau tekstin nxënësve, filloi ta lexojë atë me nxënës e pastaj zhvilloi atë sipas metodikës së përpunimit të këngës.

## Aktivite

### 1) Përgjigjuni me gojë ose me shkrim këtyre pyetjeve.

a) Çfarë kishte me vete mësuesi kësaj radhe? \_\_\_\_\_

b) Nga ishin këta nxënës e nxënëse:

Albani \_\_\_\_\_ Teuta \_\_\_\_\_

Saranda \_\_\_\_\_ Arbnora \_\_\_\_\_

Malsori \_\_\_\_\_

c) Si quhet pjesa e trojeve shqiptare në Greqi? \_\_\_\_\_

ç) Në cilat shtete shkuan shqiptarët kur u pushtuan tokat shqiptare? \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

d) Si quhen shqiptarët e migruar në Italinë e Jugut? \_\_\_\_\_

dh) A ke shokë/shoqe nga pjesë të ndryshme të trojeve shqiptare? Shkruaj nga janë

shokët/shoqet e tua! \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



*Majlinda Kelmendi:  
Serenata (pikturë)*



## 2) Mësojmë këngën “Pse jemi të ndarë”

Këngën e gjeni edhe në internet si film në youtube!

1.

Kudo qofsh ti, motërz-o,  
atje n’Çamëri,  
nga Kosova më rrah zemra,  
kur mendoj në ty.

Përtej malesh, valësh deti,  
atje n’Kalabri,  
Nga Kosova më rrah zemra  
kur mendoj në ty.

Refreni:

Ne fëmijë shqiptarë  
Pyesim pse jemi të ndarë?  
Ç’është kjo ndarje s’e kuptojmë,  
ne së bashku duam të tetojmë.

Pse po qan nëna në votër,  
pse është ndarë vëllai me motër  
edhe pse jam unë fëmijë  
kam të drejtë këtë ta di, ta di.

2.

Hape vallen shqipe  
atje në Guci,  
më ngadalë nga Bujanovci  
gjer n’Maqedoni.

Të gëzojmë se ne e kemi  
mëmë Shqipërinë,  
kudo n’botë që jemi shkputur  
th’rret me dashuri.

Refreni:  
Ne fëmijë shqiptarë  
Pyesim pse jemi të ndarë?  
Ç'është kjo ndarje s'e kuptojmë,  
ne së bashku duam të jetojmë.

Pse po qan nëna në votër,  
pse është ndarë vëllai me motër,  
edhe pse jam unë fëmijë  
kam të drejtë këtë ta di, ta di.



Hazir Mehmeti, Nexhmije Mehmetaj, Rifat Hamiti  
**NJË BOTË PËR TË GJITHË**  
**Fletore tematike - për nivelin e dytë**

Botimi i parë

Botues:

*Shtëpia botuese "DUKAGJINI" - Pejë*

Për botuesin:

*Agim Lluka*

Redaktor teknik:

*Lavdim Beqiri*

Tirazhi: 5.000 kopje

*Formati: 205x285*

U shtyp në prill 2012

në shtypshkronjën "Dukagjini" - Pejë

[www.dukagjinigroup.com](http://www.dukagjinigroup.com)

Katalogimi në botim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

37:008(=18)(076.1)

Mehmeti, Hazir,

Një botë për të gjithë: fletore tematike për nivelin e dytë /  
Hazir Mehmeti, Nexhmije Mehmetaj, Rifat Hamiti. - Botimi i parë. -  
Pejë: Dukagjini, 2012. - 48 f.: ilustr. me ngjyra; 30 cm.

1. Mehmetaj, Nexhmije 2. Hamiti, Rifat

**ISBN 978-9951-05-246-7**

*Lejohet për botim me vendim të Ministrisë së Arsimit,  
të Shkencës dhe të Teknologjisë të Kosovës, nr. 831-304, të datës 14.02.2012*